




Pranuar / Dorezuar Priljenor / Predato Received / Delivery	16. 12. 2020	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKUPITAK	3179/2020		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.318/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kane shqyrtuar ankesën me numër A.nr.318/2020, të datës 23.10.2017 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] ne adrese rr. "Ardian Krasniqi" nr.7, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.318/2020 e datës 23.10.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], i punësuar në Policinë e Kosovës sipas kontratës me numër Nr.07/1-01A/0531, të datës 02.06.2014, në pozitën "Asistent Administrativ për Administrimin e Aksidenteve të Trafikut" në njësinë Sektorin e Flotës Operative/Njësia e Shërbimeve Administrative të Flotës/Drejtoria e Logjistikës, me datën 08.05.2020 përmes e-mailit zyrtar i 'u është drejtuar Njesisë së Personelit për kompensimin e shtesës në vlerë prej 300 (treqind euro) për punën gjatë situatës me pandeminë Covid 19, për periudhën mars-prill 2020.

Njësia e Personelit respektivisht Shefja e Njesisë së Personelit të Policisë së Kosovës, me datën 12.05.2020 përmes e-mailit zyrtar e ka njoftuar ankuesin se nuk ka qenë vetëm ky i cili ka punuar gjatë muajit mars dhe se për kohën sa ka punuar e ka marrë pagën dhe lidhur me këtë çështje kërkesën ta drejtoni tek mbikëqyrësi juaj.

Ankuesi i pakënaqur me mos marrjen e shtesës, nga ana e Policisë së Kosovës, me datën 21.05.2020, ka parashtruar ankesë me numër 114-KA-2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, të Policisë së Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Policisë së Kosovës, me datën 22.09.2020 ka nxjerre vendimin me numër Nr.03/02-185, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi kundër vendimit me numër Nr.03/02-185, të datës 22.09.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Policisë së Kosovës, me datën 23.10.2020, ka parashtruar ankesën me numër te protokollit 2225/2020 ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 29.10.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Policia e Kosovës për përgjigje n ankesë. Me datën 19.11.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Policia e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2225/2020 të datës 23.10.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 22.09.2020 me numër Nr.03/02-185 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankese e ankuesit e datës 21.05.2020 me numër 114-KA-2020 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, Vendim i datës 03.04.2020 i Ministrit të Financave dhe Transfereve, Plani Operacional për pakon fiskale emergjente, E-maili zyrtar i datës 14.05.2020, E-maili zyrtar i datës 12.05.2020, E-maili zyrtar i datës 08.05.2020, Flota operative-muaji mars 2020, Flota operative muaji prill 2020, Kërkesa për përgjigje ne ankesë e datës 29.10.2020, Përgjigja ne ankesë e datës 19.11.2020 nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkangjitura, Kontrate pune e ankuesit e datës 02.06.2014, Prova shtese e datës 01.12.2012 me shkresat e bashkangjitura nga Drejtoresha e Drejtorisë se Personelit te policisë se Kosovës Vendimi me numër 22/2020 i datës 04.12.2020 i KPMSHCK-së për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës me numër A. Nr. 318/2020 të datës 23.10.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi [REDACTED], është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Qeveria në detyrë e Republikës se Kosovës me datën 30.03.2020, ka nxjerr vendimin me numër Nr.01/19 me të cilin ka aprovuar pakon emergjente fiskale, ku në piken 1 nënpikën 1.6 është parapare „sigurimi i shtesës ne vlere prej treqind (300) euro për punëtorët ne terren dhe qe janë te ekspozuar drejtpërdrejtë rrezikut te infektimit ne punën e tyre (jo i gjithë stafi i institucionit ’’), ndërsa Ministri i Financave dhe Transfereve, duke u bazuar ne vendimin e lartcekur të Qeverise me datën 03.04.2020, ka nxjerre vendimin me numër Nr.31/2020, me te cilin ka aprovuar Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, ku ne masën 6 përfshihet „sigurimi i shtesës mbi page ne vlere prej treqind (300) euro për punëtorët ne terren dhe qe janë te ekspozuar drejtpërdrejtë rrezikut te infektimit ne punën e tyre (jo i gjithë stafi i institucionit ’’), ndërsa në masën 6 pika 1 është përcaktuar se „jo i gjithë stafi i institucioneve i listuar ne këtë mase do te përfitojnë nga kjo shtese prej 300 euro meqë ajo është e kufizuar në dy kushte 1.puna ne terren dhe 2.ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj rrezikut te infektimit për shkak të punës se bere. Stafi i cili nuk i ka përmbush këto kushte(stafi administrativ, stafi i liruar, stafi ne pushim dhe kategoritë e ngjashme) nuk mund te përfitojnë nga kjo mase.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar ne provat e lendes, ka konstatuar se: me datën 03.04.2020, Shefja e Njësisë se Personelit dhe Kartelave Identifikuese në Policinë e Kosovës, duke u bazuar në vendimin e Qeverise së Republikës se Kosovës me numër nr.01/09 te datës 13.03.2020, për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit te rasteve me corona virus-covid 19, ka kërkuar nga menaxhmenti i larte i Policisë se Kosovës qe te behet reduktimi i stafit te punëtorëve dhe te punohet vetëm me staf minimal .Me datën 07.04.2020, Drejtoresha e Drejtorisë për Logjistikë në Policinë e Kosovës, ka dërguar listën finale të reduktuar maksimalisht të zyrtarëve në nivel të drejtorisë së logjistikës, në të cilën nuk ka qenë i përfshirë ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga Policia e Kosovës respektivisht listën per stafin esencial te hartuar nga Drejtorja e Logjistikes-Flota Operative si dhe vendimin me numër Nr.31/2020 te datës 03.04.2020 të Ministrit të Financave dhe Transfereve për aprovimin e pakos fiskale emergjente ka konstatuar se ankuesi nuk ka qenë i përfshirë ne këtë listë nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë, me arsyetimin se ankuesi nuk i ekspozohet rrezikut të drejtpërdrejtë të infektimit në vendin e punës andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Policia e



Kosovës ka vepruar në pajtim me masën 6 pika 1 të Vendimit me numër Nr.31/2020 të datës 03.04.2020 të Ministrit të Financave dhe Transfereve për aprovimin e pakos fiskale emergjente.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu në baze të dëshmive të ofruara ka konstatuar se ankuesi për periudhën sa ka punuar edhe është paguar me page nga Policia e Kosovës, ndërsa sa i përket kërkesës së tij lidhur me realizimin- kompensimin e shtesës për pakon emergjente covid 19 për periudhën mars-prill të vitit 2020, Kolegji konstaton se ankuesit nuk mund të realizohet kompensimi i shtesës pasi që i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet sipas masës 6 pika 1 të vendimit me numër Nr.31/2020 të datës 03.04.2020 të Ministrit të Financave dhe Transfereve, gjegjësisht nuk ka qenë në listën esenciale të hartuar nga institucioni i Policisë së Kosovës, andaj institucioni nuk ka qenë i obliguar të i'a paguaj kompensimin për shtesën në vlerën prej treqind (300) eurove për pakon emergjente fiskale.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.318/2020

Ardita PERÇUKU-SHYTI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

